



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 1028 prot.

Tiranë, më 05.12.2025

**VENDIM**  
Nr. 74, datë 05.12.2025

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË**  
**VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 64, DATË 4.11.2024**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 64, datë 4.11.2024, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Bulqizë dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës",

**KONSTATOVA SE:**

Me nr. 40, datë 21.3.2024, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Bulqizë", Komisioneri ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, duke përfshirë kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë realizimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil. në institucionin e Bashkisë Bulqizë.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 64, datë 4.11.2024, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Bulqizë dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës", të Komisionerit, ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, Komisioneri, me shkresën nr. 333 prot, datë 7.03.2025, “Kërkohet informacion mbi zbatimin e Vendimit nr. 64, datë 4.11.2024, të Komisionerit, për rregullimin e ligjshmërisë”, ka kërkuar nga institucioni informacion mbi ecurinë e procesit dhe veprimet e ndërmarra në përmbushje të detyrimeve të vendosura në dispozitivin e këtij vendimi.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Bashkia Bulqizë ka informuar Komisionerin për masat e marra me shkresën nr. 1289/1 prot, datë 19.3.2025, “Kthim përgjigje”, dhe me shkresën nr. 1289/2 prot., datë 28.3.2025, “Kthim përgjigje (shitesë dokumentacioni)”. Nga këqyrja e dokumentacionit bashkëlidhur shkresave të sipërcituara, nuk rezultoi e provuar që njësia përgjegjëse dhe aktorët e tjerë të ngarkuara me detyra të posaçme për administrimin e shërbimit civil të kishin marrë të gjitha masat e nevojshme për rikthimin e plotë të ligjshmërisë.

Sa më sipër, Komisioneri e vlerësoi të nevojshme që, me Urdhrin nr. 64, datë 2.7.2025, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim në lidhje me zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 64, datë 4.11.2024, të Komisionerit”, të urdhërojë fillimin e mbikëqyrjes në vazhdim për zbatimin e këtij vendimi, sipas drejtimeve të programit të mbikëqyrjes i cili i është njoftuar institucionit me shkresën nr. 654 prot., datë 2.7.2025. Mbi bazën e këtyre akteve, grupi i punës u paraqit në subjektin e mbikëqyrjes dhe në përfundim të procesit mbajti një akt konstatimi ku u pasqyrua situata e masave të marra për rivendosjen e ligjshmërisë dhe u administrua dokumentacioni që materializon zbatimin pjesërisht të vendimit objekt i këtij verifikimi.

Në vijim, me qëllim lehtësimin e procesit dhe sigurimin e një zbatimi sa më efektiv të detyrave të përcaktuara, është mbajtur komunikim i vazhdueshëm me njësinë përgjegjëse të subjektit, si nëpërmjet korrespondencës elektronike, ashtu edhe përmes komunikimeve telefonike, duke ofruar asistencën e nevojshme për sqarimin e paqartësive të hasura gjatë procesit të zbatimit të plotë të vendimit të Komisionerit.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 64, datë 4.11.2024, si dhe referuar informacionit të administruar në subjekt, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Për sa i përket **pikës 2** të vendimit paralajmërues Komisioneri ka kërkuar që njësia përgjegjëse të organizojë procesin e plotë të klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil, duke ngritur grupin e punës, mbledhur dhe analizuar informacionin për çdo pozicion pune, hartuar përshkrimet e punës, përgatitur dokumentacionin për vlerësim dhe ngritur Komitetin e Vlerësimit, i cili harton listën përfundimtare të klasifikimit, mbi bazën e së cilës miratohet plani i rekrutimit dhe plani i veprimit për zbatimin e vendimit.

Për zbatimin e kësaj pike janë marrë hapat administrativë si vijon:

- Me urdhrin nr. 5388, datë 28.10.2024, “Për ngritjen e komitetit të vlerësimit, në kuadër të vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil të

*Bashkisë Bulqizë*”, Sekretari i Përgjithshëm ka krijuar Komitetin e vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të pikës 29/ç, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar.

- Në vijim, Sekretari i Përgjithshëm me urdhrin nr. 5372, datë 30.10.2024, “*Në kuadër të vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil, të Bashkisë Bulqizë*”, ka ngarkuar me detyrë drejtorët e drejtorive që të vijnë me vlerësimin, përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil. Më tej, me shkresën nr. 6236 prot., datë 18.12.2024, njësia e burimeve njerëzore e institucionit ka dërguar për vlerësim pranë DAP listën përmbledhëse të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil të klasifikuara në kategorinë dhe klasën përkatëse, bashkëlidhur kësaj shkrese, ashtu siç është kërkuar nga Komisioneri në detyrat e lëna në këtë pikë të dispozitivit të vendimit paralajmërues.
- Ndërkohë, gjatë verifikimit në subjekt, grupi i punës i Komisionerit analizoi 3 përshkrime pune, të përzgjedhura në mënyrë rastësore, e konkretisht: *Drejtor në Drejtorinë e Manaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike; Përgjegjës në Sektorin Juridik dhe Prokurimet Publike dhe Specialist në Drejtorinë e Manaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike.*
- Njëkohësisht, rezulton se, Bashkia Bulqizë me urdhrin nr. 5, datë 6.1.2025, “*Për miratimin e strukturës organizative të nëpunësve civilë dhe punonjësve administrativ të Bashkisë Bulqizë dhe të institucioneve në varësi të saj*” ka miratuar strukturën, në të cilën janë pasqyruar edhe pozicionet e punës të përfshira në shërbimin civil.
- Në përfundim të procesit, Bashkia Bulqizë me aktin nr. 1091 prot., datë 28.02.2025, ka miratuar planin vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2025.

**Në pikën 3** të dispozitivit të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar që pasi të përmyllet procesi i vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil, Kryetari i Bashkisë Bulqizë të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit, për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në këtë ligj, në pozicione pune të kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues dhe ekzekutive, për 16 raste, të evidentuara nominalisht në vendim dhe të rregullojë pasojat, duke anuluar të gjitha aktet e nxjerra në kuadër të zhvillimit të procedurës së konkurrimit, duke përsëritur procedurën e konkurrimit nga e para, sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil, në secilin fazë të tij.

Nga verifikimi në subjekt i kryer në korrik 2025, rezultoi se njësia përgjegjëse ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit, por vetëm për një pjesë kishin filluar procedurat e rekrutimit, në përputhje me dispozitat ligjore. Ashtu siç është raportuar nga komunikimet e vazhdueshme me përfaqësues të bashkisë, këto procedura janë ndërprerë për shkak të largimit nga detyra të Drejtorit të Burimeve Njerëzore të

institucionit dhe ndryshimeve të tjera të ndodhura në bashki gjatë muajit korrik-gusht 2025.

Në kuadër të veprimeve të ndërmarra, rezulton se:

1. Me vendimin nr. 403, datë 31.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë, është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit nr. 225 prot., datë 17.6.2022, për punonjësin Shahin Alliu;
2. Me vendimin nr. 418, datë 31.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë, është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit nr. 224 prot., datë 17.6.2022, për punonjësin Korab Kika (*pozicioni "Përgjegjës" në Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*);
3. Me vendimin nr. 404, datë 31.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë, është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit nr. 193/1 prot., datë 4.7.2023, për punonjësin Korab Kika (*pozicioni "Drejtor" i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike*);
4. Me vendimin nr. 405, datë 31.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë, është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit nr. 193/2 prot., datë 4.7.2023, për punonjësin Aleks Sinani;
5. Me vendimin nr. 419, datë 31.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë, është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit nr. 193/3 prot., datë 4.7.2023, për punonjësen Belina Toska;
6. Me vendimin nr. 420, datë 31.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë, është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit nr. 193/5 prot., datë 4.7.2023, për punonjësin Vaide Bala;
7. Me vendimin nr. 157, datë 1.7.2024, Kryetari i Bashkisë, ka përfunduar marrëdhënien e punës, për punonjësen Malbora Uka, në pozicionin "*Përgjegjës*" në Sektorin e Buxhetit;
8. Me vendimin nr. 421, datë 31.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë, është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit nr. 193/1 prot., datë 4.7.2023, për punonjësin Arben Mera;
9. Me vendimin nr. 423, datë 31.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë, është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit nr. 193/8 prot., datë 4.7.2023, për punonjësen Emirjana Pepa;
10. Me vendimin nr. 422, datë 31.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë, është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit nr. 193/10 prot., datë 4.7.2023, për punonjësin Edison Laçi;
11. Me vendimin nr. 427, datë 31.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë, është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit nr. 193/9 prot., datë 4.7.2023, për punonjësen Eneida Lazri;
12. Me vendimin nr. 451, datë 31.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë, është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit nr. 193/11 prot., datë 4.7.2023, për punonjësen Majlinda Laçi;
13. Me vendimin nr. 426, datë 31.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë, është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit nr. 193/12 prot., datë 4.7.2023, për punonjësin Abdi Hasmeta;

14. Me vendimin nr. 425, datë 31.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë, është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit nr. 193/13 prot., datë 4.7.2023, për punonjësin Zeni Isaku;
15. Me vendimin nr. 424, datë 31.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë, është konstatuar pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit nr. 193/16 prot., datë 4.7.2023, për punonjësin Jurgen Jella;
16. Me vendimin nr. 395, datë 4.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë, është miratuar doreheqja e punonjësit Erisild Duriçi “*Specialist për Sistemin /Leje dhe Topografi*”, në Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit/Pronave dhe Emergjencave Civile.

Në pikën 4, Komisioneri ka kërkuar që pozicionet “*Specialist Protokolli*”, “*Inspektor i Mbrojtes së Territorit (IMT)*” si dhe “*Kryeinspektor i IMT*”, të trajtohen si pozicione pune jashtë administrimit të shërbimit civil; punonjësit e emëruar në këto pozicione pune duhet të vijojnë marrëdhënien e punësimit sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Nga verifikimi në subjekt dhe analizimi i strukturës u konstatua se situata nuk ishte rregulluar.

Komisioneri në pikën 5 të dispozitivit të vendimit ka kërkuar që pasi të përfundojë procedura e analizës së pozicioneve të punës, Kryetari i Bashkisë Bulqizë të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për punonjësit e emëruar me akte të përkohshme emërimi, që aktualisht janë **38 raste** dhe të rregullojë pasojat e ardhura duke rikthyer ligjshmërinë në shërbimin civil.

Nga dokumentacioni i administruar në institucion, vërejmë se Kryetari i Bashkisë ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për secilin nga punonjësit e emëruar me akte të përkohshme emërimi, mirëpo nga vlerësimi i fakteve (*struktura dhe listëpagesa e institucionit për muajin qershor*) rezultoi se shumica e punonjësve vijonin ende marrëdhënien e punësimit me insitucionin.

Në pikën 6 të dispozitivit të këtij vendimi, Komisioneri ka kërkuar nga njësia e burimeve njerëzore të plotësohen dosjen e personelit sipas përcaktimeve ligjore dhe të administrohen në dosjen përkatëse raportet mjekësore të evidentuara në raportin e mbikëqyrjes dhe në anekset e tij.

Për zbatimin e kësaj pike grupi i punës këqyri një sërë dosjesh, të cilat ishin plotësuar me raportet mjekësore.

Në përfundim, në bazë të të gjitha gjetjeve të paraqitura më sipër, vlerësoj se Bashkia Kuçovë ka zbatuar vetëm pjesërisht rekomandimet e përcaktuara në Vendimin Paralajmërues nr.64, datë 4.11.2024, të Komisionerit.

Sa i takon dy aspekteve më problematike që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil dhe rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin, vlen të theksohet se nga institucioni kanë filluar të merren masa.

Duke qenë se këto nuk janë procese të lehta dhe kërkojnë një periudhë kohore të domosdoshme përtej afatit paralajmërues të përcaktuar nga Komisioneri, si dhe mbështetur në faktin se njësia përgjegjëse ka shfaqur paqartësi në njohjen dhe më tej zbatimin e saktë të ligjit lidhur me procesin e ristrukturimit, si dhe pozicionet e plotësuar në kundërshtim me ligjin nuk janë përfshirë të gjitha në planin e rekrutimit, me synim plotësimin e tyre në përputhje të plotë me procedurat ligjore, vlerësojë se ndjekja e procesit të rivendosjes së ligjshmërisë duhet të vijojë përmes mbikëqyrjes online dhe mbikëqyrjes së orientuar për strukturat e bashkive. Në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni mund të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme ose tematike gjatë vitit 2026.

#### PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar).

#### VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 64, datë 4.11.2024, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Bulqizë dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës”.
2. Ndjekjen e detyrave të pazbatuara, të evidentuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Bulqizë
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

